

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 17 NËNTOR 2022

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot jemi për të diskutuar një projekt, i cili apriori gjithmonë do të ishte një projekt i mbështetur e pozitiv. Sigurisht, unë bashkëndaj të gjitha konsideratat për dobinë e rrugës, për leverdinë e rrugës dhe të mirat e mëdha që sjell rruga, të cilat nuk kanë nevojë për komente të gjata. Çështja qëndron këtu përpara nesh, por, përpara se sa të dëgjojmë ekzaltimin maxhorancës, e cila na kërkon pa derman që të entuziazmohemi, gjëja e parë që duhet të kërkojmë llogari është: çfarë ka ndodhur për 10 vjet; çfarë ka ndodhur me këtë izolim për 10 vjet, me këto oportunitete të mëdha, si produkte bujqësore, lëvizje më e shpejtë kapitale, të cilat do të lëviznin, leverdi financiare e të tjera?

Dikush do të pyesë: për çfarë arsye e kërkon këtë sqarim dhe këtë llogari? Do të nisem as më shumë dhe as më pak nga ato që ka thënë kjo maxhorancë. Në vitin 2014 Peleshi, aktualisht ministër, thoshte: “Pas nënshkrimit të marrëveshjes, ndërtimi i rrugës së Qafë-Plloçës pritet të nisë shumë shpejt. Ky investim është një frymëmarrje për rajonin dhe për të gjithë Shqipërinë, që lidh rajonin e Korçës dhe portet në shtetin fqinj me kryeqytetin, me tregun shqiptar”. Nuk ka asnjë gjë të keqe. Jam plotësisht dakord. Një duartrokitje e madhe, por jemi në vitin 2014.

Në vitin 2016 Kryeministri Rama, duke ndjekur punimet në rrugën Qukës–Qafë-Plloçë, ka thënë se ky është një segment i një rëndësie të veçantë për korridorin Tiranë-Korçë, që do t’i japë frymëmarrje të re, pozitive zonës dhe të gjithë vendit, do të jetë një lidhje shumë e shpejtë me portin e Durrësit; vazhdon e njëjta liturgji. Po përsëri në vitin 2016, nga maji në tetor, kthehet përsëri Rama e flet: “Ajo që na intereson ne, kuptohet pa cenuar cilësinë e punës, është të ketë ritëm maksimal për të fituar, sa të kemi, kohë.” Edhe kjo duartrokitje të forta! Çfarë thotë në vitin 2018 ministri Gjijknuri? “Me financimin shtesë, që besoj se do të bëhet i mundur (është një segment i rëndësishëm në terren të vështirë), besoj se kjo rrugë do të jetë funksionale në vitin 2019, duke e kompletuar këtë segment të rëndësishëm.”

I ka njoftuar njeri këta që vijnë sot e kërkojnë ekzaltimin tonë se jemi në vitin 2022? Nuk e di si i kanë raportet me kalendarin! Çfarë ndodh po ta sorollatin edhe 15 vjet, apo 20 vjet të tjerë? Çfarë ka

ndodhur ndërkohë që nuk ka fonde për këtë rrugë? Ndërkohë që nuk ka fonde për këtë rrugë, ne kemi parë fonde e rrugë që financohen me mbi 20 milionë euro kilometri, pra lekë me bollëk. Çfarë kemi parë tjetër? Kemi parë rificime rrugësh, siç kishit aksin Delvinë-Kardhiq me dhjetëra milionë, lekë me bollëk, jo sipas të dhënave të mia, por sipas të dhënave zyrtare po të kësaj qeverie.

Merak i madh, edhe në kohën kur kishim litarin në fyt, për t'i kompensuar me 80-100 milionë euro, se u rritën çmimet e materialeve të ndërtimit! Ka 10 vjet që na shpjegojnë se kjo rrugë do të lidhet me portin. Nuk i di njeri këto; asnjë nuk i di. E dëgjojmë këtë refren për 10 vjet. Në vitin 2022 jemi përsëri këtu e thonë se puna, që duhej të ishte mbaruar 10 vjet më parë, do të mbarojë në vitin 2024. Çfarë shikojmë më tutje?! Jo më larg se disa ditë më parë pamë se jepen koncesione rrugësh qindra milionëshe. Më e fundit është rruga nga Lekaj në Fier, e cila arrin një rekord tjetër, sepse vlera, që jepet, e kalon edhe vlerën limit të përcaktuar nga qeveria.

Nuk mbaron me 99%, siç është standardi i kuadruar 99%-99,9%, dhe ku gjithmonë fitojnë ofertat më të larta të rrugëve, asnjëherë nuk fitojnë ofertat më të ulëta dhe ky është rekordi më pozitiv i kësaj qeverie. Domethënë batërdisi e lekëve, ndërkohë që për rrugën Qukës – Qafë-Plloçë nuk kanë. Kjo e fundit e kalon edhe fondin limit, nga 317 milionë, shkon 320 milionë, sipas shifrave tuaja, jo shifrave të mia, e thyen rekordin e 99%, jemi 102%-103%. Kështu që nuk pres ndonjë kontestim nga ndonjëri, sepse, po të jetë se nuk janë të vërteta, merruni me qeverinë që gënjen. Këto shifra janë e zeza mbi të bardhë. Çfarë ndodh?! Këto koncesione shkojnë mbi 40%, dhe nga studimet e fizibilitetit të përgatitur nga vetë këta.

Njëherazi shikojmë rrugë, të cilat janë dhënë me koncesion, janë mbyllur, kanë marrë edhe paratë... 20 milionë euro të tjera do të shkojnë për skarpatet te Rruga e Arbrit. Nuk mbarojnë kurrë edhe ato. Vetëm gjejnë ditirambet: “atë që nuk gjetëm; atë që bëtë; kishit disa pasaktësia në projekte, të cilat duan 10 vjet të sqarohen, por mungonin disa lekë, duan 10 vjet të tjerë që të sqarohen” ndërkohë që këto, që grabiten kollaj, këto ecin dhe janë miliona euro. Çfarë shikojmë tjetër?! Shikojmë që merak i madh është të japin rrugë që u vihet trau, pra në çdo rast paguajnë qytetarët, se merak i madh është që të paguajnë ata. Qytetarët i paguajnë rrugët me 7-8 fishin e çmimit, jo sipas nesh, por sipas raporteve të Bashkimit Europian dhe sipas çmimeve të tyre.

Shqipëria i bën ato 7 herë më të shtrenjta se Brukseli. Besoj se këtu duhet të skuqen dhe të turpërohen të gjithë. Të mos flasin fare për këtë punë, ta votojnë ashtu në heshtje, nuk ka problem, por jo të na mbushin mendjen se po ndodh mrekullia. Kjo që po ndodh, është batërdi me rrugët, me cilësinë e tyre

dhe me çmime joeuropiane, të cilat, thashë që janë shumë më të larta se europianet, qoftë edhe për një zgjerim rruge. Koncesioni më i fundit 46 kilometra, 3,8 kilometra i ka gjurmë të re, sipas raportit të qeverisë, jo sipas meje. Vetëm zgjerimet e rrugës shkojnë miliona euro, sikur të ishte rrugë shumë e re dhe në terren të vështirë. Këto janë të vërteta dhe këto kanë qindra e qindra milionë euro. Ndërsa për rrugën bekuar, Qukës – Qafë-Ploçë nuk ka para; gjithmonë mungojnë paratë për të; nuk gjenden paratë; gjithmonë ka ngërc të madh dhe popullit i thuhet dënglat e radhës.

Përgatitet një video e bërë bukur me pamje shumica 3D, 4D, 4K e të tjera. Ngopuni me këto; rrugë hiç! Lekët nga ana tjetër janë merak i madh. Ata që i kanë marrë me 99% tenderët, marrin edhe 100 milionë të tjerë, që janë votuar nga kjo sallë, sepse u ka lëvizur pak çmimi. Nuk u mjaftonte 99%-shi, por duhej kompensoheshin edhe ato materiale, që janë marrë nga 20 herë. Kjo batërdis që ndodh me rrugët, e cila është bërë rëndom e zakonshme të përmendet nga institucionet ndërkombëtare, si përkujdesja, standardi dhe mosmonitorimi, miratimi i akteve të supervizionit me rrugë mizerabël për sa i takon cilësisë e të tjera, bën që ne të dëgjojmë edhe një herë tjetër liturgjinë e 10 vjetëve radhazi.

Të gjithë presin të entuziazmohemi, të mos dëgjojmë dhe të mos japin asnjë argument, por të themi: kënaquni, sepse tani, pasi i batërdisët rrugët anë e mbanë, u kujtuat për këtë rrugën, e cila mbase mbaron nga viti 2024. Këto janë të vërtetat e mëdha dhe nuk mund të ketë asnjë alibi apo justifikim për ta zgjatur kaq gjatë një projekt jetik për një zonë të zhvilluar, me potencial të shkëlqyer turistik, të cilën batërdia e korrupsionit më rrugë të tjera, qofshin të panevojshme apo që mund të presin, por nuk pret grabitja e pazari i bërë, e la të rrijë gjithmonë në anë.

Ndërkohë, dëgjojmë metrat, centimetrat dhe disnivelet, sikur parlamenti është keq për të dëgjuar këto lloje detajesh, të cilat mund t'i zgjidhin edhe këta, të cilët, kur duan, i zgjidhin e i këpusin edhe 26 milionë euro kilometri e mbarojmë brenda natës. Nuk kursejnë as fadromën dhe asgjë tjetër; nuk pyesin as për qytetarët, por i nxjerrin përjashta dhe patjetër vënë traun. Ndaj, njoftojnë gjithmonë se do të keni segment, por me tra, siç është ai që fillon nga Thumana, i cili deri në Fier ka nja 4-5 pagesë dhe deri në fund duhet të paguajnë 10 mijë lekë të vjetër.

Kjo pagesë do t'u bjerë qytetarëve shqiptarë, ndonëse i kanë paguar këto rrugë sa frëngu pulën. Sigurisht, nuk ka asnjë arsye për të votuar kundër, por është një turp i madh që të dëgjojmë përrallat e kësaj mrekullie dhe duhet të mrekullohemi që, pas 10 vjetëve batërdisje me fondet e rrugëve, më në fund i erdhi radha kësaj rruge dhe nga përrallat propagandistike mbase përfundon në vitin 2024.